



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE E QARKUT TIRANË  
SHKOLLA 9-VJEÇARE "BASHKIM BERISHA" NDROQ

Nr.271Prot

Ndroq, më 15.04.2015

**NJOFTIM PËR KONKURIM PËR VEND TË LIRE PUNE**

Shkolla 9-vjeçare "Bashkim Berisha", Ndroq/ Tiranë, në zbatim të Ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimit Nr.35, datë 30.09.2014 "Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe të largimit nga puna të mësuesit në institucionin publik të arsimit parauniversitar", shpall njoftimin e kërkesave për konkurim, për vendin e lirë të punës në pozicionin **Mësues/e(biologji-kimi)** në :

1. Shkolla 9-vjeçare "Bashkim Berisha", Ndroq/Tiranë. Të gjithë mësuesit e këtij profili (profili biologji-kimi), të interesuar për këtë pozicion pune (**Mësues biologji-kimi**), duhet të paraqesin pranë drejtorisë së Shkollës 9-vjeçare "Bashkim Berisha", Ndroq/Tiranë, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Diplomë të ciklit të dytë të studimeve universitare, sipas përcaktimeve të nenit 57 të Ligjit Nr.69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", (fotokopje e noterizuar e diplomës dhe listës së notave të shkollës së lartë).

b) CV dhe kopje të dëshmimeve apo dokumente që vërtetojnë pohimet në CV (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën Nr.1, bashkëlidhur Udhëzimit Nr.35, datë 30.09.2014).

c) Tabelën e të dhënave për aplikant (Sipas modelit të përcaktuar në shtojcën Nr. 2, bashkëlidhur Udhëzimit Nr.35, datë 30.09.2014).

d) Raportin mjeko - ligjor.

e) Dëshminë e masave disiplinore në fuqi në ngarkim të tij. (Nëse nuk ka e deklaron me shkrim që nuk ka).

f) Dëshminë e penalitetit, të lëshuar jo më herët se tre muaj para datës së aplikimit.

Dorëzimi i dokumentacionit të aplikimit për konkurim , do të bëhet pranë drejtorisë së Shkollës 9-vjeçare “Bashkim Berisha”, Ndroq/ Tiranë, me adresë: Rruga Nacionale Tiranë-Ndroq, kilometri 19 , cdo ditë nga ora 08:00 – 14:00.

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të aplikimit për konkurim , do të jetë data 25.04.2015 ora 14.00.

Dokumentacioni për aplikim dorëzohet në drejtorinë e Shkollës 9-vjeçare “Bashkim Berisha”, Ndroq/ Tiranë, me procesverbal dorëzimi.

